

Delegacioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit merr pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 30 vjetorit të krijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kroacisë

Delegacioni i institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit i përfaqësuar nga Znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm, Z. Bledar Doracaj, Drejtor i Departamentit të Vetëqeverisjes Vendore, Znj. Joana Troqe, Drejtor i Departamentit të Buxhetit të Shtetit, dhe Z. Paolo Xhezo,



Drejtor i Departamentit të Departamentit të Auditimit të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Pronës Publike, mori pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 30 vjetorit të krijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kroacisë të cilat u zhvilluan në Zagreb, në datat 20-21 Nëntor 2024.

Gjatë fjalës hapëse të konferencës së organizuar me rastin e 30 vjetorit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, Z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm, falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, si dhe për kontributin e deritanishëm të institucionit si një dëshmi e përkushtimit për transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje të mirë.

Konferenca u pasua me përshëndetjen e përfaqësuesve të Komisionit të Financës dhe Buxhetit të Shtetit të Parlamentit Kroat, të Ministrisë së Financës, të fakulteteve, si dhe të SAI-eve të Austrisë, Sllovakisë, Çekisë, Sllovenisë dhe Malit të Zi, të cilët shprehën urimet e tyre për përvjetorin e krijimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, duke përmbledhur arritjet kryesore përgjatë këtyre viteve sipas fushave respektive.

Në përfundim, Z. Klešić shprehu gatishmërinë e tij dhe të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë për të përmirësuar rezultatet e punës së institucionit dhe intensifikimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët me SAI-et homologe, me qëllim shkëmbimin e përvojave më të mira mbi cilësinë e auditimit.

